



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.21, datë 30.04.2007

**PËR  
NJË NDRYSHIM NË NUMRIN E PUNONJËSVE TË  
QENDRËS EKONOMIKE TË ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32, gërma "ç", Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.14, datë 10.03.2004 "Për strukturën organizative dhe nivelin e pagave të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve", ndryshuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.8, datë 21.03.2005, pas shqyrtimit të relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë një ndryshim në numrin e punonjësve të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve.
2. Pika 3 e Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.8, datë 21.03.2005, "Për disa ndryshime në strukturën organizative të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve", ndryshon si vijon:  
"Miratohet numri i punonjësve 503 të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve të Qytetit të Tiranës, sipas organigramës bashkëlidhur këtij Vendimi".
3. Rekrutimi i kujdestareve të fëmijëve të kryhet vetëm bazuar në shtesën e numrit të fëmijëve dhe normativën e miratuar.
4. Efektet financiare të këtij Vendimi të përballohen nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2007.
5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

**K R Y E T A R I**

**SOKOL DERVISHAJ**